

VENDIM
Nr. 87, datë 4.3.2021

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME
LUSHNJË SHA

Në mbështetje të nenit 13, 14, 15, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”(VKM nr. 958), si dhe të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 4.3.2021, pasi shqyrtoi çështjen me objekt: “Mbi miratimin e vendimit ‘Për licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a.’”,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë (UK Lushnjë), me shkresën nr. 79 prot. ERRU, datë 11.2.2021, ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim licence për shkak të mbarimit të afatit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit të UK Lushnjë në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit, si dhe në zbatim të parashikimeve të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

3. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton se:

a) Shoqëria UK Lushnjë ofron shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për 92 000 banorë të Bashkisë Lushnjë;

b) Drejtuese teknike e shoqërisë, znj. Xhesikjana Boçi, është diplomuar në Universitetin Politeknik, në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike, profili energjitik, në nëntor të vitit 2020.

4. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për licencim për shkak të mbarimit të afatit, ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Lushnjë, të:

a) kërkesave të ligjit nr. 8102, si dhe kuadrin rregullator në fuqi, në mënyrë të veçantë plotësimin e kushteve si: aftësi tekniko-profesionale, aftësi financiare të nevojshme për të përmbushur funksionet dhe për të plotësuar kushtet e licencës, përvojën në sektorin e ujësjellësve dhe kanalizimeve të mjaftueshme për të marrë përsipër detyrimet që ka licenca, si dhe mbrojtjen e interesave të konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit;

b) kërkesave të ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003, “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, të ndryshuar, (ligji nr. 9121), për mos lejimin e abuzimit me pozitën dominuese në treg të ndërmarrjes veçanërisht në lidhje me kufizimin e tregjeve.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se kërkesa e UK Lushnjë është e bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a., me (NUIS K04223405T), në kategoritë:

- a) Kategoria A - Për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik;
- b) Kategoria C - Për largimin e ujërave të ndotura.

2. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. autorizohet të kryejë veprimtaritë e licencuara me:

- a) Drejtues ligjor: Erjet Dhima;
- b) Drejtuese teknike: Xhesikjana Boçi.

3. Zona e shërbimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. është Bashkia Lushnjë.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 4-vjeçare.

5. Drejtuesi ligjor i shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. detyrohet të nënshkruajë kushtet e licencës brenda 10 ditëve nga data e njoftimit.

6. Ngarkohet Drejtoria Tekniko-Ekonomike të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Lushnjë sh.a. për marrjen e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani